



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




Emri i biznesit: "Radio Gjilani.1NN" SH.P.K. -

Numri Unik Identifikues: 810057449

Drejtor: Nijazi Selimi dhe Naser Emini

OSHMA: Radio Gjilani

Adresa: Bulevardi i Pavarsisë, Kati 1



VENDIM

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio – Radio Gjilani, me seli në Gjilan

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Gjilani është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësor analog të programeve të radios, me seli në Gjilan. KPM, me vendimin e datës 06 qershor 2016, lëshimin e licencës së Radio Gjilani për një afat prej shtatë (7) vitesh, ndërsa më datën 06 korrik 2023, skadon afati i licencës së Radio Gjilanit.
3. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mail ju ka dërguar shkresë të gjitha radiove të cilave afti i licencës ju skadon licenca në vitin 2023, në mesin e tyre edhe Radio Gjilani, përmes së cilës shkresë i ka njoftuar lidhur me skadimin e afatit të licencës dhe mundësin e ripërtëritjes së saj në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komisioni i Pavarur të Mediave.
4. Më datën 05 maj 2023, Radio Gjilani ka dorëzuar kërkesë me shkrim në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar ripërtëritjen e licencës.
5. Për shkak të mungesës së kuorumit për vendimmarrje të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga data 15 tetor 2022 deri më datën 6 qershor 2023, kërkesa e kandidatit Radio Gjilani nuk ka arritur të shqyrtohet me kohë.

Arsyetim

6. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
7. Neni 25 i Ligjit të KPM-së përcakton: *Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audio vizuel privat për sa u përket kushteve dhe kriterëve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.*
8. Me anë të shkresës së datës 18 prill 2023, lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të licencës, KPM gjithashtu, ka njoftuar Radio Gjilani lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për ripërtëritjen e licencës.
9. Komisioni konstaton se, Radio Gjilani përmes kërkesës me shkrim ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve mediale audio (radio) në lokacionin për të cilin është licencuar.
10. Komisioni e KPM-së konsideron se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga ana e ofruesit të shërbimit medial, të Radio Gjilani të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje e licencës.
11. Komisioni konstaton se Radio Gjilani ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM - së, përfshirë këtu edhe pagesën e tarifës administrative për ripërtëritje të licencës, e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
12. Komisioni konstaton se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Gjilani është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
13. Duke marr parasysh faktin që Radio Gjilani ka dorëzuar kërkesë me shkrim, përmes së cilës ka shprehur interesim për ripërtëritjen e licencës për të vazhduar veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve mediale audio, nuk janë evidentuar shkelje serioze të dispozitave materiale si dhe se ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM-së, Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Gjilani i plotëson kushtet për miratim dhe njëherësh ripërtëritja e licencës së kësaj radioje është në interesin e publikut në zonën në të cilën operon Radio Gjilani.

Vendim

14. Komisioni në takimin e datës 17 korrik 2023, vendos që ta miratojë kërkesën për ripërtëritjen e licencës së Radio Gjilani, në mënyrë që të vazhdojë me veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve mediale audio, e cila veprimtari është në interes të publikut në lokacionin për të cilin është licencuar dhe në të cilin është duke transmetuar program Radio Gjilani.

15. Licenca e Radio Gjilani do të jetë e vlefshme për një afat prej shtatë (7) vitesh, ashtu siç është përcaktuar me Nenin 21, paragrafin 2, të Ligjit për KPM-në, ndërsa vlefshmëria e afatit të licencës do të llogaritet nga data 06 qershor 2023.
16. Të gjitha parametrat e licencës së Radio Gjilani, siç janë: kategoria e të licencuarit, skema programore, parametrat teknike dhe harta e zonës së mbulimit do të mbesin të pandryshuar nga licenca paraprake.
17. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Jeton Mehmeti
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



17.07.2023
datë